

Bazuar në nenin 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 6 i Rregullores për punë të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (tekst i pastruar) nr.01-3732/1 nga 29.07.2019, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale në seancën e 17-të e mbajtur më 09.05.2022, në lidhje me Informacionin mbi kërkesën e dorëzuar nga Shoqata e stacioneve TV rajonale dhe lokale — Medium Objektiv, me propozim konkluzë, nr.03-1722/4 nga 06.05.2022, miratoi si në vijim:

K O N K L U Z Ë

1. Këshilli i Agjencisë, duke pasur parasysh situatën e rënduar ekonomike dhe financiare të TV rajonale dhe lokale që shkaktoi pandemia e Kovid 19-të, miratoi konkluzë që Agjencia të mbështesë kërkesat e mëposhtme të Shoqatës së stacioneve TV rajonale dhe lokale – Medium Objektiv.:

- derisa Qeveria është në gjendje që të sigurojë shtesa financiare plotësuese për mbulimin e shpenzimeve për tarifën e lejes për transmetim për vitin 2022 në vlerë prej 50%;
- gjithashtu nëse është në gjendje të sigurojë mbulimin e shpenzimeve për transmetimit të televizioneve rajonale që transmetojnë program përmes DVB-T, si dhe mbulimin e shpenzimeve të të gjitha televizioneve që transmetojnë nëpërmjet operatorit të rrjetit publik të komunikimit elektronik dhe për të cilin paguajnë tarifë, dhe
- Agjencia të japë mbështetje për nisjen e debatit publik në lidhje me kërkesën për “ krijimin e një fondi për media me anë të të cilit do të subvencionohen përmbajtje programore dhe tregime kërkimore me tematikë rajonale dhe lokale, për zhvillim të ofertës programore dhe stimulim të demokracisë pluraliste në shoqëri”.

2. Kopje e Konkluzionit duhet tu dorëzohet:

- Udhëheqësve të sektorëve në Agjenci,
- Sektorit për përkrahje të punës së Këshillit të Agjencisë,
- Sektori për mbështetje informative dhe punë të përgjithshme – arkivi i Agjencisë.

Nr. 02-1904/4
09.05.2022
Shkup

Agjencia për shërbime mediatike
audio dhe audiovizuale
Kretar i Këshillit

Lazo PETRUSHEVSKI d.v